

**VENDIM**  
**Nr. 887, datë 12.12.2012**

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK  
PËR NDËRTIMIN E LINJËS KABLLORE 20 KV TË NDËRTESES SË RE, PËR  
PROKURORINË E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, si autoritet kontraktor, të përfundojë, brenda datës 30 dhjetor 2012, procedurën e prokurimit, me objekt “Ndërtimi i linjës kabllorë 20 kV për ndërtesën e re të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë”, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2012.

Brenda këtij afati përfshihen botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar, realizimi i kontratës dhe ekzekutimi i pagesave për këtë kontratë.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**